



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA ELBASAN
DREJTORIA E PROKURIMEVE PUBLIKE DHE INVESTIMEVE**

Nr. _____ prot.

Elbasan, më _____.____.2026

LËNDA: Dërgim njoftimi për botim në Buletin e Prokurimit Publik.

AGJENCISË së PROKURIMIT PUBLIK

TIRANË

**FORMULARI I NJOFTIMIT TË FITUESIT, PAS PUBLIKIMIT TË TË CILIT FILLOJNË
AFATET E ANKIMIMIT**

Nga: Agjencia e Sherbimeve Publike Urbane, Bashkia Elbasan adresa: Lagja “Visarion Xhuvani”, Elbasan

Drejtuar: **“R. S. & M” sh.p.k. me nipt K32203002I**, me adrese ; Tirane Tirane TIRANE
AUTOSTRADE KM 2

- *OE/BOE* me nënkontraktor

PO ☐

JO *X*

- *OE/BOE* me Subjekt Mbështetës:

PO ☐

JO *X*

Tipi i Kontratës: MALL

Lloji i Procedurës së prokurimit: **Procedurë e Hapur e thjeshtuar-Marreveshje kuader**

Numri i referencës së procedurës/lotit: REF-91591-06-29-2026

Data e Publikimit të Njoftimit të Kontratës në SPE: **30.06.2026**

Data e publikimit te kontrates ne Buletin e Njoftimeve Publike: Buletini Nr. 42 datë 6 korrik 2026

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “Blerje Materiale Për Sinjalistikë Horizontale (Bojëra, Diluent, Etj)”, me fond limit **2,498,000** (dymilionë e katërqind e nëntëdhjetë e tetëmijë) **lekë pa tvsh** .

KRITERET E PËRZGJEDHJES SË FITUESIT:

- oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në kosto ☐
-oferta ekonomisht më e favorshme bazuar në çmim ☒

Me anë të këtij Formulari bëjmë me dije se, në këtë procedurë /lot kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë të mëposhtëm me vlerat përkatëse, si më poshtë:

1. “R. S. & M” sh.p.k. me Nipt: K32203002I

Vlera e ofruar është **1,873,750** (Një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) **lekë pa t.v.sh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2. “TEKNOKOLOR” sh.p.k. me Nipt: K92728401J

Vlera e ofruar është **1,618,225** (Një milion e gjashtëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e njëzet e pesë) **lekë pa t.v.sh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

3. “SARK” sh.p.k. me Nipt: K52531415H

Vlera e ofruar është **2,017,500** (Dy milionë e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) **lekë pa t.v.sh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

4. “ZEQIRI” sh.p.k me Nipt: J67902827A

Vlera e ofruar është **1,751,400** (Një milion e shtatëqind e pesëdhjetë e një mijë e katërqind) **lekë pa t.v.sh.**

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

Nga pjesëmarrësit janë s'kualifikuar, Ofertuesit e mëposhtëm:

1. “TEKNOKOLOR” sh.p.k. me Nipt: K92728401J

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

1.O.E TEKNOKOLOR SH.P.K me NIPT K92728401J ka paraqitur dokumentacion te pasakte tekniko-ligjor si me poshte :

1.1. O.E TEKNOKOLOR SH.P.K në përmbushje të kriterit 4.1 ku operatori ekonomik duhet te paraqese te pakten nje moster per elementet e meposhtem sipas preventivit dhe specifikimeve teknike te kerkuara ne daten dhe oren e hapjes se tenderit ne ambjentet e Agjencise se Sherbimeve Publike Urbane Elbasan,konstatojme se ky operator nuk u paraqit per te dorezuar mostrat e kerkuara.

O.E nuk ka permbushur kriterin 4.1 ku ne baze te nenit 77,te ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” dhe nenin 40 ,pika 6/a te VKM nr.285,date 19.05.2021 “Per miratimin e rregullave te Prokurimit Publik”,kerkohet qe operatoret ekonomike te paraqesin mostra te mallit qe kerkohet te prokurohet,kur kjo kerkohet nga autoriteti kontraktor si e rendesishme per vleresimin e ofertes,**prandaj komisioni I vleresimit te ofertave vendosi ta skualifikoje kete oferte.**

1.2. O.E TEKNOKOLOR SH.P.K në përmbushje të kriterëve të veçanta të kualifikimit,pika a) ,ku operatori ekonomik duhet te paraqese Formularin e Sigurimit te Ofertes,sipas shtojces nr.4,konstatojme se ky operator nuk e ka ngarkuar formularin e mesiperm.

O.E nuk ka permbushur piken a) tek kriteret e veçanta te kualifikimit ku ne baze te nenit 83,te ligjit nr.162 date 23.12.2020 “Per prokurimin publik” parashikohet qe AK duhet te kerkoje paraqitjen e sigurimit te ofertes nga ofertuesit ne te gjitha llojet e procedurave te prokurimit,me perjashtim te procedurave te prokurimit me vlere te vogel, **prandaj komisioni I vleresimit te ofertave vendosi ta skualifikoje kete oferte.**

1.3. O.E TEKNOKOLOR SH.P.K në përmbushje të kriterit 3.3 te Kapaciteti Teknik dhe Profesional,ku OE ofertues duhet të jetë i pajisur me çertifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim, si më poshtë:

-SSH/ EN - ISO 9001:2015 në fushën e menaxhimit të cilësisë ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

-SSH/ EN - ISO 14001 : 2015 , në fushën e menaxhimit të mjedisit ose ekuivalente, e vlefshme dhe të përputhet me mallin objekt prokurimi;

Konstatojme se nuk ka ngarkuar asnje dokument per te deshmuar disponimin e tyre.

O.E nuk ka permbushur kriterin 3.3 te Kapaciteti Teknik dhe Profesional,ku bazuar ne nenin 40 pika 6 germa (c) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

bazuar në nenin 44 pika 1 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 si dhe bazuar në nenin 79 të LPP, OE ofertues duhet të jetë i pajisur me certifikatë të lëshuar nga organizmat e vlerësimit të konformitetit, të akredituara nga DPA, ose organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë, që ka lidhje me objektin e kontratës, lëshuar nga institucionet zyrtare të akredituara për këtë qëllim, **prandaj komisioni I vlerësimit të ofertave vendosi ta skualifikojë këtë ofertë.**

1.4. O.E TEKNOKOLOR SH.P.K në përmbushje të kriterit 4.2, ku operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim të prodhuesit/ distributorit për çdo artikull të kërkuar për tu dorëzuar si mostër. Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, si : telefon, fax, e-mail, website, datën e lëshimit të autorizimit, kohëzgjatjen e vlefshmërisë së autorizimit, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në raste verifikimesh të mëtejshme. Në rast të disponimit të autorizimit të prodhuesit / distributorit në gjuhë të huaj, ky dokument të paraqitet i përkthyer e i noterizuar në gjuhën shqipe. Në rastet e paraqitjes së autorizimeve nga një distributor, duhet të vërtetohet lidhja ndërmjet Prodhuesit dhe Distributorit të Autorizuar, konstatohet se OE ka ngarkuar Autorizim në gjuhë të huaj.

O.E nuk ka përmbushur kriterin 4.2 bazuar në nenin 40, pika 6 germa b dhe pika 8, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndaj **komisioni I vlerësimit të ofertave vendosi ta skualifikojë këtë ofertë.**

1.5. O.E TEKNOKOLOR SH.P.K në përmbushje të kriterit 4.3, ku duhet të paraqesë Katalogë ose fragmente të katalogëve të prodhuesit për listën e mallrave të kërkuar për tu dorëzuar si mostër, në të cilën të tregohen dhe të specifikohen qartë materialet që do të ofrohen, për të krahasuar pajtueshmërinë e specifikimeve teknike dhe standarteve të kërkuara dhe skedën teknike për mallrat në të cilën duhet të paraqiten të dhëna të sakta të kodit të produktit dhe web i firmës furnizuese, konstatohet se nuk ka paraqitur kataloge për mallrat e kërkuar.

O.E nuk ka përmbushur kriterin 4.3 bazuar në nenin 40 pika 6 , germa b dhe c dhe pika 8 të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndaj komisioni I vlerësimit të ofertave vendosi ta skualifikojë këtë ofertë.

Oferta juaj refuzohet për arsyen e mësipërme.

2. “ZEQIRI” sh.p.k me Nipt: J67902827A

OE/BOE me nënkontraktor

PO ☐ JO ☒

Nëse po, të jepen dhënat _____

(Emrat e nënkontraktorëve , Nipt-et, % e nënkontraktimit)

2.O.E ZEQIRI SH.P.K me NIPT J67902827A ka paraqitur dokumentacion të pasakte tekniko-ligjor si më poshtë :

2.1. O.E ZEQIRI SH.P.K në përmbushje të kriterit 4.1 ku operatori ekonomik duhet të paraqesë të paktën një mostër për elementet e mëposhtme sipas preventivit dhe specifikimeve teknike të kërkuara në datën dhe orën e hapjes së tenderit në ambjentet e Agjencisë së Sherbimeve Publike Urbane Elbasan, konstatohet se u paraqit se bashku me mostrat dhe procesverbalin e dorëzimit të tyre. Komisioni I vlerësimit të ofertave vendosi se mostrat e

paraqitura nuk permbushin kërkesat për specifikimet teknike të përcaktuara në DST, për këtë arsye ky OE do të skualifikohet.

OE nuk ka përmbushur kriterin 4.1 bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 40, pika 6/a të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të Prokurimit Publik” për të paraqitur mostra të mallit që kërkohej të prokurohej në përputhje me kërkesat e specifikimeve teknike të prokuruar, **ndaj komisioni I vleresimit të ofertave vendosi ta skualifikojë këtë ofertë.**

2.2. O.E ZEQRIRI SH.P.K në përmbushje të kriterit 3.1 Kapaciteti teknik dhe profesional për të provuar përvojën e mëparshme ku operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizime të ngjashme në një vlerë jo më të vogël se 20% e vlerës së përlogaritur të kontratës, që prokurohet dhe që është realizuar gjatë tre viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

Kjo do të vërtetohet me dokumentat e mëposhtme:

- a) **Në rastin e përvojes së mëparshme të realizuar me sektorin publik,** operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të leshuara nga një ent publik ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat, sasi të mallrave të furnizuara,

ose

- b) **Në rast se përvoja e mëparshme është realizuar me sektorin privat,** si dëshmi do të pranohen vetëm fatura tatimore shitje, të plotësuara sipas kërkesave të legjislativës në fuqi, dhe/ose të deklaruara në organet tatimore, ku të jenë shënuar saktë datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Konstatohet se ky OE ka ngarkuar Faturën 32/2025 datë 3.07.2025, ku zerat e fatures që konsiderohen furnizim i ngjashëm me objektin e prokurimit sipas specifikimeve teknike, janë në një vlerë jo më të vogël se 20% të vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet.

OE nuk ka përmbushur kriterin 3.1 referuar në nenin 40 pika 4 dhe nenin 55, pika 4 germa b) të VKM-së Nr.285, datë 19.5.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe bazuar në nenin 77 pika 4 të LPP nr.162, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, **ndaj komisioni I vleresimit të ofertave vendosi ta skualifikojë këtë ofertë.**

Oferta juaj refuzohet për arsyen e mësipërme.

Në këto kushte, komisioni I vleresimit të ofertave bëri klasifikimin si më poshtë:

- 1- **Në vendin e parë klasifikohet ofertuesi, “R. S. & M” sh.p.k** me vlerën e ofertuar prej **1,873,750** (Një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) lekë (pa tvsh).
- 2- **Në vendin e dytë klasifikohet ofertuesi, “SARK” sh.p.k.,** me vlerën e ofertuar prej **2,017,500** (Dy milionë e shtatëmbëdhjetë mijë e pesëqind) lekë pa tvsh.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë operatorin ekonomik **“R. S. & M” sh.p.k. me nipt K32203002I**, me adrese ; Tirane Tirane TIRANE AUTOSTRADE KM 2, se oferta e paraqitur me vleren prej **1,873,750** (Një milion e tetëqind e shtatëdhjetë e tre mijë e shtatëqind e pesëdhjetë) **lekë pa t.v.sh.** , është identifikuar si ofertues i suksesshem.

Me publikimin e këtij njoftimi, fillojnë afatet e ankimit sipas përcaktimeve në nenin 110 të Ligjit Nr. 162/2020, datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar

TITULLARI I AUTORITETIT KONTRAKTOR
DREJTOR I PERGJITHSHEM I ASHPU
EDVIN PALLOSHI